



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 174, Datë 03.08.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË  
“OSOJA ENERGY”SH.P.K, NR.408, SERIA P18K, DHËNË ME VENDIMIN E  
BORDIT TË ERE NR. 113, DATË 14.05.2018, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “SEMAN 1” ME  
VENDNDODHJE, SHEQ MARINAS, TOPOJË, FIER ME FUQI 2 MW, PËR NJË  
AFAT 20 VJEÇAR, NË FAVOR TË SHOQËRISË “SEMAN 1 SOLAR” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16, dhe nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 10 pika 1; nenit 17 pikat 1 dhe 4; të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96 datë 17 .06.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për transferimin e licencës së shoqërisë “Osoja Energy”sh.p.k, nr.408, seria P18K, dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 113, datë 14.05.2018, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Seman 1” me vendndodhje, Sheq Marinas, Topojë, Fier me fuqi 2 MW, për një afat 20 vjeçar, tek shoqëria “Seman 1 Solar” sh.p.k,

**Konstatohet se:**

- Me shkresën me nr. 413 Prot., datë 24.05.2018, shoqëria “OSOJA ENERGY” sh.p.k, ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin e licencës së kësaj shoqërie , me nr.408, seria P18K, dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 14.05.2018, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Seman 1” me vendndodhje, Sheq Marinas, Topojë, Fier me fuqi 2 MW, për një afat 20 vjeçar, tek shoqëria “Seman 1 Solar” sh.p.k,
- Shoqëria “OSOJA ENERGY” sh.p.k, ka marrë miratimin nga MIE me nr. 3245/1 Prot, datë 20.04.2018 “Miratimi i transferimit të të drejtave”, për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve që disponon në respekt të miratimit përfundimtar nr. 3887/2 Prot., 23.12.2017 dhe kontratës së lidhur me MIE, nr. 1163 Rep dhe nr. 376 Kol, datë 29.12.2017, për Ndërtimin, shfrytëzimin dhe Administrimin e Centralit Fotovoltaiik “Seman -1” me

kapacitet instaluar 2 MW”, në zonën Sheq Marinas – Topojë Fier në favor të shoqërisë “Seman 1 Solar” sh.p.k

- Në mbledhjen e Bordit të datës 25.06.2018, në të cilën u relatua relacioni nr. 54/6 Prot., datë 14.06.2018, “Mbi fillimin e procedurës për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Osoja Energy” sh.p.k, nr. 408, Seria P18 K dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 113, datë 14.05.2018, për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Seman 1” me vendodhje, Sheq Marinas, Topojë, Fier me fuqi 2 MW, për një afat 20 vjeçar dhe kalimin e saj në favor të shoqërisë “Seman 1 Solar” sh.p.k., nga Bordi i ERE-s u la detyrë kryerja e disa saktësimeve nga ana e aplikuesit.
- Në vijim të sa më sipër, ERE me shkresën nr. 413/1 Prot., datë 28.06.2018, iu drejtua subjektit “Osoja Energy” sh.p.k duke i kërkuar:
  - Formatin e Aplikimit të plotësuar sipas nenit 9 pika 1 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”;
  - Vërtetimin e Organeve Drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për transferimin e licencës, sipas nenit 17, pika 4 gërma “c” të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”
  - Saktësime në lidhje me pagesën e kryer për aplikimin, sipas nenit 8 pika 2 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”
- Subjekti me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 413/2 Prot., datë 16.07.2018 ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar më sipër dhe ka dhënë sqarimet përkatëse në lidhje me kryerjen e pagesës së aplikimit.  
Aplikimi i shoqërisë “Osoja Energy” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “ *Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, si më poshtë:

- ✓ Neni 8 pika 2,
- ✓ Neni 9, pika 1
- ✓ Neni 17, pika 1,
- ✓ Neni 17, pika 4,

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës së shoqërisë “Osoja Energy”sh.p.k, nr.408, seria p18k, dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 113, datë 14.05.2018, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Seman 1” me vendndodhje, Sheq Marinas, Topojë, Fier me fuqi 2 MW, për një afat 20 vjeçar, tek shoqëria “Seman 1 Solar” sh.p.k,
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.